



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Ref. Nr. 01/150

Datë: 27.10.2022

Mbështetur në nenet 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, nenin 46 paragrafët dhe 2 dhe paragrafi 2 i nenit 48 të Ligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, si dhe nenin 8. paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe shtojcën 12 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr këtë:

VENDIM

1. Vazhdohet masa mbrojtëse antidamping dhe masat kundërbalancuese në vlerë 0.04 euro cent për importin e miellit nga Serbia.

Arsyetim

Në kuadër të Departamentit të Tregtisë respektivisht Komisioni për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe i cili me datën 20.10.2022 ka mbajtur takimin lidhur me Analizën e ri vlerësimit të masës mbrojtëse anti-damping mbi sektorin e prodhimit të Miellit në Kosovë dhe importin nga Serbia. Në kuadër të kësaj analize janë krahasuar të dhënat e importit të miellit nga Serbia në tregun e Kosovës të cilat tregojnë që ka rënie të importit në periudhën e viteve 2017-2022.

Para vendosjes së masës antidamping, për importin e miellit nga Serbia, në vitin 2017 importi i miellit ka qenë më i madhe ndërsa pas vendosjes së masës mbrojtëse, në vitin 2018 të dhënat tregojnë për rënie të importit të miellit. Rënia më e madhe e importit të miellit nga Serbia është shënuar në vitin 2019.

Bazuar në analizën e Departamentit të Tregtisë për këto të dhëna, ku vërejmë se efektet e masës janë evidente, si dhe bazuar në rekomandimin e Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe për vazhdimin e masës.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshillë juridike: Ky vendim është akt përfundimtar në procedurën administrative. Pala e pakënaqur mund të nisë konflikt administrativ në gjykatën kompetente.



U dërgohet:

- Kabinetit të Ministres ;
- Doganës;
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Tregtisë;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.